



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Ministarstvo Rada i Socialne Zaštite-
Ministry of Labour and Social Ėelfare

Departamenti Ligjor/Zakonodavni Departamenta/Legal Department

Në përputhje me Nenin 1 paragrafi 1.3 Pika (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh vonesen e miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2008.

Me qëllim të aplikimit të drejt dhe te plotë të Ligjit 02/L-2 Për Statusin dhe të Drejtat e Familjëve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.03/2008
PËR
RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PAGESËS TË
PENSIONEVE TE PERCAKTUARA SIPAS LIGJIT
NR. 02/L-2 PËR VITIN 2008

Neni 1
Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave administrative, për pagesën e pensioneve për vitin 2008 të përcaktuara me Ligjin Nr.02/L-2 për Statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve,pjesëtarëve dhe familjeve të viktimave civile të luftës.

Neni 2

Mënyrat e pagesës së pensioneve

Pagesat në skemën e pensioneve të përcaktuara me Ligjin Nr.02/L-2 për vitin 2008, nga të gjithë aplikuesit do të realizohen në mënyrë retroaktive nga 01.01.2008 deri më 30.06.2008 .

Neni 3

Arsyet e Pagesës Retroaktive të Pensioneve

Pagesat e pensioneve të përcaktuara me Ligjin 02/L-2, do të paguhen në mënyrë retroaktive, nga 01.01.2008, për shkak të mosmiratimit të buxhetit të Kosovës, deri në muajin mars të vitit 2008, si dhe për shkak të mospranimi të aplikacioneve të reja për kategoritë e trajtuara në Ligj, në mungesë të mjeteve buxhetore, të cilët me rastin e implementimit të tërësishëm të Ligjit, për herë të parë duhet të aplikojnë për realizimin e të drejtës në pension.

Neni 4

Lartësia e Shumës së Pensioneve

(1) Të gjithë aplikuesit të cilët parashtrojnë kërkesë për të përfutur të drejtën në skemën e pensioneve të luftës të përcaktuara me Ligjin Nr.02/L-2 do të realizojnë pensionin e plotë në lartësi sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Ligjin e përmendur.

(2) Shfrytëzuesit e pensioneve të cilët kanë realizuar pensionet në lartësi prej 75% të bazës së pensionit për tremujorin janar-mars 2008 në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.02/2007 të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës do të realizojnë diferencën e pensionit prej 25% nga 01.01.2008.

(3) Gjithashtu të gjithë shfrytëzuesit e pensioneve për periudhën janar-mars 2008 të cilët i kanë realizuar pensionet në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/66, do të paguhet diferenca e pensionit, nga 01.01.2008 në përputhje me kushtet dhe kriteret për lartësinë e pensionit të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-2.

Neni 5

Procedurat dhe afatet kohore për aplikim

(1) Të gjithë personat të cilët aplikojnë për njohjen e të drejtës në pension, duhet zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.02/L-2 dhe të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2006 për procedurat e aplikimit në skemën e pensioneve të luftës.

(2) Afati për aplikim për njohjen e të drejtës në mënyrë retroaktive, për realizimin e të drejtës në pension sipas Ligjit, është deri më 30.06.2008.

(3) Të gjithë personat të cilët do të aplikojnë deri më datën 30.06.2008 dhe që e fitojnë të drejtën në pension sipas dispozitave të Ligjit Nr.02/L-2, pagesa e pensioneve do të bëhet në mënyrë retroaktive nga 01.01.2008 .

(3) Të gjithë personat të cilët aplikojnë pas afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni , nuk mund ta realizojnë pensionin në mënyrë retroaktive .

Neni 6

Zbatimi i Udhëzimit Administrativ

Për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij Udhëzimi Administrativ ngarkohet Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave civile të MPMS-së.

Neni 7

Hyrja ne Fuqi

Ku Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqnies Sociale, ndërsa do të aplikohet prej datës 01.01.2008 deri më 30.06.2008.

Prishtinë, Mars 2008

Ministri i MPMS-së
Nenad Rašić